



Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-353/01-62408

Dt. 02. 09. 2025

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR KK – PRIZREN, me kërkesën e **Nail Haskuka** me banim në rrugën Zahir Pajaziti nr. 11 - Prizren, me numër të kërkesës **04-353/01-62408** të datës 22. 05. 2025 në bazë të nenit 3. pika 1.11 si dhe nenit 5 alineja 1 Pika 1.3 e në kuptim të nenit 14 alineja – 1 pika 1.5 dhe nenit 15 alineja 1 pika 1.1 dhe neni 19 alineja 2 të Ligjit për Ndërtim Numër 04/L-110 si dhe konform dispozitave të dhe neneve 26 paragrafi 1, nenet 27, 44, 46, 47, 48 dhe 86 të Ligjit për Procedurën Përgjithshme Administrative-LPPA-së numër 05/L-031, e lidhur me dispozitat e neni 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe sipas vendimit për miratimin e HZK për periudhën 2022-2030 Numër 001-011-48192 të datës 31. 03. 2022 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. **LEJOHET: Nail Haskuka** nga Prizreni, në zhvillimin e punimeve: **Renovimin e objektit dhe ndrimin e kulmit** (si në projekt), në objektin shtëpi individuale për banim, me numër **O-71813068-188-0-1-0** ZK Prizren me sipërfaqe **S = 56 m²** e cila gjendet në rrugën Zahir Pajaziti nr. 11 - Prizren.

II. Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit të veçantë.

III. Gjatë renovimit nuk lejohet kurrfarë ndryshimi, zgjerimi në gabarit dhe në etazhitet të objektit.

IV. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin e ndërtimtarisë në afat prej 8 ditësh.

V. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se me punë nuk fillohet brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.

A r s y e t i m

Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara së bashku me kërkesë vërtetohet se: **Nail Haskuka** me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.


Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për renovimin e objekteve të KK Prizren, është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për Renovimin e objektit dhe ndrimin e kulmit (si në projekt), në objektin **shtëpi individuale për banim**, me numër **O-71813068-188-0-1-0** ZK Prizren me sipërfaqe **S = 56 m²** e cila gjendet në rrugën Zahir Pajaziti nr. 11 - Prizren.

KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, përmes këtij organi.


Ankesa taksohet me 0,50 € taksa administrative.

Bashkëpunëtor profesional:


Ylber Gashi, inxh. dip. ark.



DREJTORI:


Pranverim Berisha, jur. dip.